



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2026 – Numri: 105

Tiranë – E premte, 22 maj 2026

PËRMBAJTJA

		Faqe
Udhëzim i ministrit të Punëve të Brendshme nr. 98, datë 14.5.2026	Për përcaktimin e procedurave për aplikimin, vlerësimin, miratimin dhe refuzimin e kërkesës për shpalljen e statusit të pashtetësisë.....	9409
Urdhër i ministrit të Punëve të Brendshme nr. 101, datë 19.5.2026	Për delegimin e kompetencave.....	9417
Vendim i Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut datë 5.5.2026	Çështja Bitraj kundër Shqipërisë (<i>kërkesa nr. 10024/17</i>).....	9417
Vendim i Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut datë 5.5.2026	Çështja Metalla kundër Shqipërisë (<i>kërkesa nr. 19646/20</i>).....	9420
Vendim i Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut datë 7.5.2026	Hasan Zela kundër Shqipërisë (<i>kërkesa nr. 55595/17</i>).....	9426
Vendim i Bordit të Transparencës dhe Kufizimit të Përkohshëm të Çmimeve të Tregtimit me Shumicë/Pakicë të Nënprodukteve të Naftës dhe Gazit nr. 25, datë 21.5.2026	Për miratimin e çmimit tavan të tregtimit me shumicë/pakicë të nënprodukteve të naftës dhe të gazit.....	9428
Urdhër i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës nr. 125, datë 11.5.2026	Për delegimin e kryerjes së detyrave që kanë të bëjnë me procedurat e prokurimit publik.....	9429



UDHËZIM

Nr. 98, datë 14.5.2026

**PËR PËRCAKTIMIN E PROCEDURAVE
PËR APLIKIMIN, VLERËSIMIN,
MIRATIMIN DHE REFUZIMIN E
KËRKESËS PËR SHPALLJEN E
STATUSIT TË PASHTETËSISË**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës; të nenit 54, pika 3, të ligjit nr. 79/2021, “Për të huajt”, të ndryshuar,

UDHËZOJ:

1. Personat e huaj që gjenden pa shtetësi në territorin e Republikës së Shqipërisë mund të paraqesin kërkesë pranë autoritetit shtetëror qendror përgjegjës për përcaktimin e statusit të pashtetësisë, në ministrinë përgjegjëse për çështjet e rendit dhe sigurisë publike, për shpallje të statusit të pashtetësisë.

2. Kërkesa për shpalljen e statusit të pashtetësisë paraqitet personalisht nga i huaji ose nga përfaqësuesi i autorizuar, shoqëruar me formularin e aplikimit të përcaktuar në aneksin nr. 1, bashkëlidhur dhe pjesë e këtij udhëzimi, duke bashkëngjitur dokumentacionin si vijon:

a) certifikatë lindjeje apo dëshmi e lëshuar nga spitali pas lindjes;

b) certifikatë martese nëse është i martuar;

c) dokument identifikimi ose udhëtimi të prindërve, bashkëshortit/es ose fëmijëve;

ç) dokument udhëtimi (përfshirë edhe ato që i ka mbaruar afati);

d) dokument që vërteton vendbanimin në Republikën e Shqipërisë;

dh) dokument që vërteton vendbanimin e fundit/mëparshëm jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë;

e) dokument apo dëshmi të lëshuar nga autoriteti i huaj që vërteton se personi nuk është shtetas i shtetit përkatës;

ë) dëshmi që nuk është nën ndjekje dhe i dënuar për vepra penale, lëshuar nga prokuroria e rrethit gjyqësor dhe gjykata e rrethit gjyqësor, ku ka vendbanimin në Republikën e Shqipërisë.

3. Në rastet kur kërkesi është fëmijë apo person me aftësi të kufizuara, kërkesa bëhet nga prindi, kujdestari ose përfaqësuesi ligjor i autorizuar.

4. Autoritetit shtetëror qendror përgjegjës për përcaktimin e statusit të pashtetësisë, pas shqyrtimit të kërkesës, lëshon një vërtetim për pranimin e kërkesës.

5. Në rastet kur gjatë shqyrtimit të kërkesës për shpalljen e statusit të pashtetësisë konstatohet se nga kërkesi ekziston edhe një kërkesë për mbrojtje ndërkombëtare, mbrojtje plotësuese apo mbrojtje shtesë, me aprovimin e kërkesit, do të ndërpritet procedura për këtë status. Personi do të konsiderohet si azilkërkues dhe do të trajtohet sipas dispozitave të ligjit nr. 10/2021, “Për azilin në Republikën e Shqipërisë”.

6. Brenda 30 ditëve nga depozitimi i kërkesës dhe dokumentacionit të përcaktuar në këtë udhëzim, kërkesi do t’i nënshtrohet intervistës, e cila do të kryhet në gjuhën që ai/ajo kupton me prezencën e përkthyesit.

7. Pas dorëzimit të kërkesës dhe dokumentacionit të nevojshëm, autoritetit shtetëror qendror, përgjegjës për përcaktimin e statusit të pashtetësisë, njofton kërkesin për ditën dhe orën e intervistës, të paktën pesë (5) ditë para zhvillimit të saj.

8. Para intervistës sektori përgjegjës bën një vlerësim të plotë të dosjes, duke përfshirë:

a) shqyrtimin e kërkesës dhe formularit të aplikimit;

b) shqyrtimin e dokumentacionit shoqërues të kërkesës;

c) identifikimin e dokumentacionit të munguar apo të paqartë, për të cilin mund të kërkohej informacion/plotësim ose shpjegim gjatë intervistës.

9. Intervista do të zhvillohet në kushte konfidenciale me prezencën edhe të:

a) përfaqësuesit ligjor të autorizuar;

b) përfaqësuesit të UNHCR-së.

10. Në intervistën me fëmijë dhe persona me aftësi të kufizuara duhet të jenë prezent:

a) kujdestari ligjor për fëmijët e pashoqëruar;

b) kujdestari për persona me aftësi të kufizuara;

c) përkthyesi.

11. Gjatë zhvillimit të intervistës mblidhen të dhënat, lidhur me çështjet:

a) identiteti i saktë i kërkesit për statusin e pashtetësisë dhe i anëtarëve të tjerë të familjes;

b) mënyrën e hyrjes në territorin e Republikës së Shqipërisë;

c) faktin nëse kanë paraqitur kërkesën për shtetësi apo për njohjen e statusit të personit pa shtetësi në ndonjë shtet tjetër;



c) lidhja me ndonjë shtet tjetër, si: vendi i lindjes, prejardhjes së prindërve, vendbanimit, martesës apo lindjes së fëmijëve të tyre.

12. Intervista do të dokumentohet në një procesverbal, i cili do t'i komunikohet në gjuhën që ai/ajo kupton dhe do të nënshkruhet nga kërkuesi, sektori përgjegjës, si dhe pjesëmarrësit e tjerë në intervistë.

13. Gjatë zhvillimit të procedurës mbledhet informacion nga vendi i origjinës për situatën politike, ekonomike, sociale dhe situatën e të drejtave të njeriut nga shtetet me të cilat kërkuesi ka lidhje të mundshme të shtetësisë, si:

a) shtetit të lindjes;

b) shtetit në të cilin personi ka pasur vendbanimin e fundit;

c) shtetit apo shteteve të shtetësisë së prindërve/bashkëshortëve.

14. Pas zhvillimit të intervistës nga punonjësi, autoriteti përgjegjës nis procesin e verifikimit dhe nëse është e nevojshme, merr informacione edhe përmes institucioneve përkatëse të përfaqësive të huaja diplomatike dhe organizatave ndërkombëtare.

15. Autoriteti përgjegjës shqyrton dhe analizon dëshminë e dhënë gjatë intervistës, si dhe të gjithë dokumentacionin e depozituar, për të vërtetuar saktësinë e dëshmisë së dhënë dhe provave të ofruara gjatë procedurës.

16. Pas vlerësimit të të gjithë aplikimit, autoritetit shtetëror qendror përgjegjës për përcaktimin e statusit të pashtetësisë harton vendimin së bashku me rekomandimin e nënshkruar prej tyre, për shpalljen ose refuzimin e statusit të pashtetësisë, sipas aneksit nr. 2, bashkëlidhur këtij udhëzimi.

17. Vendimi përcillet për miratim pranë Drejtorit të Përgjithshëm për Politikën e Shtetësisë, brenda periudhës kohore prej njëqind e tetëdhjetë (180) ditësh nga data e aplikimit.

18. Drejtori i Përgjithshëm për Politikën e Shtetësisë ka të drejtë të japë rekomandime shtesë dhe ta kthejë dosjen për rishqyrtim në rast të mosdakordësisë me rekomandimet e përcjella nga autoriteti shtetëror qendror, përgjegjës për përcaktimin e statusit të pashtetësisë.

19. Afati i përcaktuar në pikën 18, mund të zgjatet për një periudhë shtesë prej 3 (tre) muaj, në rastet kur:

a) kemi të bëjmë me çështje komplekse, faktike ose ligjore;

b) një numër i madh i shtetasve të huaj kanë paraqitur njëherësh kërkesë për përcaktimin e statusit të pashtetësisë, duke e bërë të vështirë në praktikë përfundimin e procedurës brenda afatit 6-mujor (gjashtëmujor). Në këto raste, autoriteti përgjegjës informon kërkuesin për arsyet e shtyrjes dhe afatet kohore brenda të cilave pritet të merret vendimi për kërkesën e tij.

20. Kërkuesi ose përfaqësuesi i autorizuar njoftohet me shkrim brenda pesë (5) ditësh pune nga data e marrjes së vendimit.

21. Kundër vendimit të refuzimit të shpalljes së statusit të pashtetësisë, kërkuesi ka të drejtën të ankohet në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

22. Udhëzimi i ministrit të Brendshëm nr. 87, datë 21.6.2023, “Mbi dokumentacionin dhe procedurën për aplikimin, vlerësimin, miratimin dhe refuzimin e kërkesës për shpalljen e statusit të pashtetësisë”, shfuqizohet.

23. Për zbatimin e këtij udhëzimi ngarkohet struktura përgjegjëse për çështjet e shtetësisë në Ministrinë e Punëve të Brendshme.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I PUNËVE TË BRENDSHME
Besfort Lamallari



Aneksi nr. 1

Anex no. 1



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME

MINISTRY OF INTERNAL AFFAIRS

FORMULAR APLIKIMI PËR SHPALLJEN E STATUSIT TË PERSONIT PA SHTETËSI
APPLICATION FORM FOR THE DECLARATION OF STATELESS PERSON STATUS

1. Informacion mbi aplikantin <i>1. Information on the applicant</i>			
1.1 Të dhëna personale <i>1.1 Personal information</i>			
Mbiemri <i>Surname</i>		Emrat <i>Names</i>	
Emri i nënës <i>Mother's name</i>		Emri i babait <i>Father's name</i>	
Datëlindja <i>Birthdate</i> (dd.mm.yyyy)		Shteti i lindjes <i>Country of birth</i>	
Vendi i lindjes/ <i>Birth place</i>		Shtetësia(të) e mëparshme <i>Former citizenship/s</i>	
Gjinia/Gender ☐ Mashkull/Male ☐ Femër/Female ☐ E panjohur/Other			
Gjendja Civile/Civil Status ☐ Martuar/Married ☐ Beqar/Single ☐ Divorcuar/Divorced ☐ I(e) Ve / Ëidoë ☐ Partner Civil / Civil Partner			
Profesioni dhe/ose trajnimi: <i>Profession and/or training:</i>		Gjuha mëmë: <i>Mother tongue</i>	
1.2 Informacioni i kontaktit <i>1.2 Contact information</i>			
Adresa <i>Address</i>			
Rruga: Nr. <i>Street No.</i>			
Fshat/ Qyteti -Shteti <i>Village/ City-Country</i>			
Tel./cel./fax <i>Phone/Telephone/Fax</i>			
Email			
2. Informacion mbi anëtarët e familjes <i>2. Information on family members</i>			
2.1 Bashkëshorti ose partneri civil <i>2.1 Spouse or Civil partner</i> ☐ I pamartuar/Unmarried			
Mbiemri <i>Surname</i>		Emrat <i>Names</i>	
Datëlindja <i>Birthdate</i> (dd.mm.yyyy)			
Shtetësia(të) aktuale <i>Current citizenship/s</i>			
Adresa (rruga, nr., qyteti/ fshati) <i>Address (street, no, city, village)</i>			



2.2 Fëmijë të mitur në kujdestari <i>2.2 Minor children under your custodianship</i> ☐ Nuk kam fëmijë në kujdestari <i>I don't have children under my custodianship</i>				
Ju lutemi deklaroni të gjithë fëmijët në kujdestari <i>Please declare all the children under your custodianship</i>				
Emri/ <i>Name</i>	Mbiemri/ <i>Surname</i>	Datëlindja/ <i>Birthdate</i> (ddmmyyyy)		
Nëse keni më shumë se pesë fëmijë, fusni informacionin e fëmijëve të mbetur në një aneks të veçantë <i>If you have more than five children, enter the remaining children's information in a separate annex</i>				
3. Kushtet e hyrjes në Republikën e Shqipërisë <i>3. Conditions of entry in the Republic of Albania</i>				
Kur dhe në cilin PKK keni hyrë në Shqipëri (dd.mm.yyyy)? <i>When and at which Border Crossing Point (BCP) did you enter Albania (dd.mm.yyyy)?</i>				
Datë/ <i>Date</i> :		PKK/ <i>BCP</i> :		
Mënyra e hyrjes/ <i>Method of entry</i> : Me vizë/ <i>With a visa</i> _____ Specifikoj llojin e vizës/ <i>Specify type of visa</i> _____				
Dokumentet e udhëtimit me të cilat keni hyrë në territorin e Shqipërisë/ <i>The travel documents with which you entered the territory of Albania</i> : _____ (Pasaportë/ <i>Passport</i> , Laisser-passer,...)				
Autoriteti që ka lëshuar dokumentin/ <i>Authority that issued the document</i> : _____				
Vendi i lëshimit/ <i>Issuing place</i> : _____ Nr./ <i>No</i> : _____				
Data e lëshimit/ <i>Issuing date</i> : _____		Data e skadimit/ <i>Expiration date</i> : _____		
4. Vendbanimet e mëparshme jashtë vendit <i>4. Previous residences abroad</i>				
SHTETI <i>COUNTRY</i>	QYTETET <i>CITIES</i>	NËN ÇFARË STATUSI <i>UNDER WHAT STATUS</i>	DATAT <i>DATES</i>	ADRESA <i>ADDRESS</i>
A keni kërkuar mbrojtje nga ndonjë ambasadë/konsullatë në Shqipëri apo jashtë? <i>Have you sought protection from any Embassy/Consulate in Albania or abroad?</i> Po Jo <i>Yes No</i>				
Nëse po, specifikoj cilën ambasadë/konsullatë, si dhe datën, arsyet dhe rezultatet e kësaj përpjekjeje: <i>If yes, specify which Embassy/Consulate, as well as the date, reasons and results of this attempt:</i>				
A keni kërkuar azil/mbrojtje ndërkombëtare/mbrojtje plotësuese në Shqipëri? <i>Have you applied for asylum/international protection/subsidiary protection in Albania?</i>				
Po Jo <i>Yes No</i>				



Nëse po, shënoni numrin tuaj të rastit/ *If yes, enter your case number:* _____

Statusi i aplikimit/ *application status:* _____

5. Arsyet për kërkesën tuaj

5. Reasons for your request

Për çfarë arsye jeni duke aplikuar për status të personit të pashtetësi?

For what reason are you applying for stateless person status?

Shkruaj një pasqyrë të saktë dhe të personalizuar të rrethanave në të cilat juve ju është mohuar shtetësia. Ju duhet të specifikoni çfarë masash keni ndërmarrë për të fituar shtetësinë, duke bashkëngjitur të gjitha dokumentet e ndërlidhura me procedurë. Dokumentet e lëshuara nga autoritetet e huaja dhe që deklarojnë se ju nuk keni shtetësi të asnjë nga vendet me të cilat mund të jetë e lidhur situata juaj, duhet t'i bashkëngjiten dosjes.

Write an accurate and personalized account of the circumstances in which you were denied citizenship.

You must specify what measures you have taken to obtain citizenship by attaching all documents related to the procedure. Documents issued by foreign authorities stating that you do not have the citizenship of any of the countries to which your situation may be related must be attached to the file.

6. Deklarime përfundimtare

6. Final statements

Foto

Photo

Unë po aplikoj për statusin e pashtetësisë në Shqipëri dhe nëpërmjet kësaj, konfirmoj me nënshkrimin tim që informacioni i paraqitur në këtë aplikim dhe shtojcat e tij janë korrekte dhe të sakta.

I am applying for stateless status in Albania and hereby confirm with my signature that the information presented in this application and its attachments are accurate and correct.

Unë jam i vetëdijshëm se duke u dorëzuar autoriteteve dokumentacion të rremë dhe informacion personal të rremë me shkrim, është një vepër e dënueshme sipas Kodit Penal në Shqipëri.

I am aware that submitting false documentation and personal written information to the authorities is a punishable offense under the Criminal Code of Albania.

Vendi dhe data

Place and date

Nënshkrimi

Signature

Emri në shkronja kapitale

Name in capital letters

Nënshkrimi i fëmijës nëse është mbi 18 vjeç: _____

Signature of the child if he/she is over 18 years old

Emri në shkronja kapitale

Name in capital letters



7. Shtojca të detyrueshme 7. Mandatory attachments	PO YES	JO NO
Dokumentet që i duhen bashkëngjitur kërkesës për njohjen e statusit të personit pashtetësi <i>Documents that must be attached to the request for the recognition of the stateless person's status</i>		
Certifikata e lindjes apo ndonjë dokument tjetër ekuivalent <i>Birth certificate or any other equivalent document</i>		
Dëshmi e lëshuar nga spitali pas lindjes <i>Certificate issued by the hospital after birth</i>		
Dokument identifikimi- letërnjoftim, pasaportë apo dokument i udhëtimit për të huaj (përfshirë edhe ato me afat të skaduar) <i>Identification document - identity card, passport or travel document for foreigners (including expired ones)</i>		
Certifikata e martesës <i>Marriage certificate</i>		
Dokument identifikimi ose udhëtimi të prindërve, bashkëshortit ose fëmijëve <i>Identification or travel document of parents, spouse or children</i>		
Dokumentet e imigrimit apo lejet e vendbanimit të shtetit të mëhershëm të vendbanimit <i>Immigration documents or residence permit of the former state of residence</i>		
Një dokument apo dëshmi e lëshuar nga autoriteti i huaj që vërteton se personi nuk është shtetasi i shtetit përkatës <i>A document or certificate issued by a foreign authority certifying that the person is not a citizen of the relevant country</i>		
Vërtetim që nuk është nën hetim penal dhe që nuk është i dënuar për vepra penale, e lëshuar nga prokuroria e rrethit gjyqësor dhe nga gjykata e rrethit gjyqësor ku ka vendbanimin në Republikën e Shqipërisë <i>Certificate that she/he is not under criminal investigation and that she/he has not been convicted of criminal offenses, issued by the Prosecutor's Office of the Judicial District and by the Court of the Judicial District where he resides in the Republic of Albania</i>		
2 fotografi identike jo më të vjetra se 6 muaj <i>2 Identical photographs taken within the last 6 months</i>		
Dokumente të tjera relevante bashkëngjitur me këtë kërkesë: <i>Other relevant documents attached to this request:</i>		
1.		
2.		
3.		
4.		
5.		
6.		

Kërkesa e pranuar në datë _____
Request accepted on date

Nënshkrimi i punonjësit përgjegjës në Ministrinë e Punëve të Brendshme

The signature of the responsible employee at the Ministry of the Internal Affairs

SHËNIM. Të dhënat e depozituara në këtë kërkesë do të trajtohen në bazë të legjislacionit kombëtar për mbrojtjen e të dhënave dhe parimit të konfidencialitetit.
NOTE: The data submitted in this application will be treated in accordance with national data protection legislation and the principle of confidentiality.



Aneks nr. 2

Anex no. 2



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E _____
DREJTORIA E POLITIKAVE PËR SHTETËSINË
MINISTRY OF INTERNAL AFFAIRS
GENERAL DIRECTORATE OF _____
DIRECTORATE OF CITIZENSHIP POLICY

VENDIM
DECISION

Sot më datë dd.mm.yy, Drejtoria e Politikave për Shtetësinë, në Ministrinë e Punëve të Brendshme, mori në shqyrtim kërkesën për shpalljen e statusit të pashtetësisë në Republikën e Shqipërisë, të kërkuarit **emër mbiemër**. Drejtoria, pasi shqyrtoi dokumentacionin dhe dëshminë e dhënë gjatë intervistës, konstatoi:

*Today, on DD.MM.YY, the Directorate of Citizenship Policies, in the Ministry of the Internal Affairs, considered the request for the declaration of statelessness status in the Republic of Albania, of the applicant's **name and surname**. The Directorate, after reviewing the documentation and the testimony given during the interview, concluded:*

I. Subjekti:

I. Subject

Z./Znj. EMËR MBIEMËR

Mr./Ms NAME SURNAME

Emri/Name:

Mbiemri/Surname:

Atësia/Father's name:

Seksi/Sex:

Vendlindja/Birthplace:

Datëlindja/Birthdate:

Arsimi/Education:

Gj. Civile/Civil Status:

Kombësia/Nationality:

Shtetësia/Citizenship:

II. Baza ligjore: Neni 40 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; ligji nr. 79/2021, “Për të huajt”, i ndryshuar, Konventa për statusin e personave pashtetësi, dhe Konventa për reduktimin e pashtetësisë.

II. Legal Basis: Article 40 of the Constitution of the Republic of Albania; Law no. 79/2021 “For foreigners”, as amended, Convention on the status of stateless persons, and Convention on the reduction of statelessness.

III. Përmbledhje e hapave procedural:

III. Summary of procedural steps:

1. Hyrja në territorin e Republikës së Shqipërisë (data dhe vendi i hyrjes)

Entry into the territory of the Republic of Albania (date and place of entry)



2. Data e vetëdeklarimit të pashtetësisë së tij/saj (sigurohet nga Formulari i Përzgjedhjes së Shtetasve të Huaj të Parregullt).

Date of self-declaration of his/her statelessness (provided by the Irregular Foreign Nationals Selection Form).

3. Shqyrtimi i kërkesës për përcaktimin e statusit të pashtetësisë

(shënohet data e shqyrtimit të kërkesës);

Examination of the request for determining the Status of Statelessness (the date of consideration of the request is noted);

Kërkuesi ka parashtruar faktet lidhur me kërkesën e tij bazuar në parashikimet e këtij udhëzimi në gjuhën _____ (shënohet gjuha që flet kërkuesi në prani të një përkthyesi zyrtar).

The applicant has submitted the facts related to his request based on the provisions of this instruction in _____ language (the language spoken by the applicant in the presence of an official translator is noted).

IV. Deklarimi i fakteve

IV. Statement of facts

Faktet e çështjes

The facts of the case

Këtu të jepet një përmbledhje e fakteve të parashtruara nga kërkuesi _____, si dhe provave të mbledhura gjatë verifikimit nga drejtoria përgjegjëse.

Here is a summary of the facts presented by the applicant _____, as well as the evidence collected during the verification by the Responsible Directorate.

V. Arsyetimi

V. Justification

Në këtë pjesë jepet arsyetimi i bërë nga kërkuesi nëse plotëson kriteret e parashikuara në udhëzim.

In this part, the justification given by the applicant if it meets the criteria provided in the instruction is given.

Sipas pasrashikimeve të ligjit nr. 79/2021, “Për të huajt”, të ndryshuar, pika 30, e nenit 3, të këtij ligji jep përkufizimin e termit “Person pa shtetësi”, ku citohet se:

According to the provisions of the law no. 79/2021 “For foreigners”, as amended, point 30 of article 3 of this law defines the term “Stateless person”, where it is quoted that:

“Person pa shtetësi” është personi, i cili nuk ka shtetësinë e asnjë shteti.

“Stateless person” is a person who does not have the citizenship of any country”.

Nga shqyrtimi i çështjes në tërësi (dokumentacion dhe intervistë) Drejtoria e Politikave për Shtetësinë vlerëson nëse kërkuesi i plotëson të gjithë kriteret dhe dokumentacionin e parashikuar nga ky udhëzim për shpalljen e statusit të pashtetësisë në Republikën e Shqipërisë.

From the consideration of the case as a whole (documentation and interview), the Directorate of Citizenship Policies assesses whether the applicant meets all the criteria and documentation provided by this instruction for the declaration of statelessness status in the Republic of Albania.

Në rastet kur kërkuesi nuk plotëson kushtet e parashikuara nga ky udhëzim, por plotëson kushtet për njohjen e statusit të refugjatit apo mbrojtjes plotësuese, sipas pasrashikimeve të ligjit nr. 10/2021, “Për azilin në Republikën e Shqipërisë”, atëherë me aprovimin e tij/saj do të vijohet me procedurat për njohjen e këtij statusi dhe do të anulohet procedura për shpalljen e statusit të pashtetësisë.

In cases where the applicant does not meet the conditions provided by this instruction, but meets the conditions for recognition of refugee status or subsidiary protection, according to the provisions of law no. 10/2021 “On Asylum in the Republic of Albania”, then with his/her approval the procedures for the recognition of this status will be continued and the procedure for the declaration of statelessness will be cancelled.

Për sa më sipër, Drejtoria e Politikave për Shtetësinë vlerëson se janë shfaqur arsye thelbësore për të besuar se ky shtetas i përmbush kriteret për t’ju shpallur statusi i personit pashtetësi (sipas rastit).

As per the above, the Directorate of Citizenship Policies, estimates that substantial reasons have appeared to believe that this citizen fulfills the criteria to declare the Stateless Person Status (according to the individual case).



PËR KËTO ARSYE,
FOR THESE REASONS,

bazuar në nenin 54, të ligjit nr. 79/2021, “Për të huajt”, të ndryshuar, dhe udhëzimit _____.202____,
Drejtoria e Politikave për Shtetësinë,
Based on Article 54 of Law no. 79/2021 “For foreigners”, as amended, and the instruction _____.202____,
Directorate of Citizenship Policies ,

VENDOSI:
DECIDED:

Shpalljen e statusit të personit pashtetësi në Republikën e Shqipërisë, për z/znj. **Emër Mbiemër.**
Declaration of Stateless Person Status in the Republic of Albania, for Mr./Mrs. Name Surname.

DREJTORI I PËRGJITHSHËM I ZHVILLIMIT PËR MIGRACIONIN DHE AZILIN
General Director of Migration and Asylum Development

Miratoi: Drejtori i Politikave për Shtetësinë _____.
Approved by: Director of Citizenship Policies

Përgatiti: Punonjësi përgjegjës _____.
Prepared by: Responsible employee

URDHËR
Nr. 101, datë 19.5.2026

PËR DELEGIMIN E KOMPETENCAVE

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; të neneve 28 dhe 29, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurës Administrative të Republikës së Shqipërisë”; të pikave 2 dhe 3, të nenit 11, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, dhe të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të titullarit të Ministrisë së Punëve të Brendshme nga data 21.5.2026 deri më datë 22.5.2026, zëvendësministrit të Punëve të Brendshme, znj. Anisa Ruseti.

2. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohet zëvendësministri i Punëve të Brendshme, znj. Anisa Ruseti.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I PUNËVE TË BRENDSHME
Besfort Lamallari

GJYKATA EVROPIANE E TË DREJTAVE
TË NJERIUT
SEKSIONI I TRETË

ÇËSHTJA BITRAJ KUNDËR SHQIPËRISË
(Kërkesa nr. 10024/17)

VENDIM

STRASBURG
5 maj 2026

Ky vendim është përfundimtar, por mund të jetë subjekt i rishikimit redaktues.

Në çështjen Bitraj kundër Shqipërisë

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (Seksioni i Tretë), e mbledhur si një Komitet i përbërë nga:

Úna Ní Raifeartaigh, Kryetar,

Darian Pavli,

Mateja Đurović, gjyqtarë

dhe Olga Chernishova, zëvendëssekretare e Seksionit,

Duke mbajtur në konsideratë:

kërkesën (nr. 10024/17) kundër Republikës së Shqipërisë depozituar në Gjykatë, më 31 janar 2017, në mbështetje të nenit 34 të Konventës për



Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore (Konventa), nga një shtetas shqiptar, z. Klaidin Bitraj (kërkuesi), i cili ka lindur në vitin 1974, jeton në Tiranë, dhe u përfaqësua nga z. D. Matlija, dhe z. T. Alexandridis, avokatë të cilët e ushtrojnë profesionin në Tiranë;

vendimin për të njoftuar qeverinë shqiptare (Qeveria), e përfaqësuar nga Agjenti i saj, z. O Moçka, Avokati i Përgjithshëm i Shtetit, në lidhje me ankesat;

vërejtjet e palëve;

Pasi diskutoi me dyer të mbyllura, më 31 mars 2026,

Shpall vendimin e mëposhtëm, që u miratua në të njëjtën datë:

LËNDA E ÇËSHTJES

1. Çështja ka të bëjë me një shkelje të pretenduar të së drejtës së kërkuesit për t'iu drejtuar Gjykatës Kushtetuese dhe garancive të tjera të gjyqimit të drejtë sipas nenit 6 §§1, 2 dhe 3 të Konventës.

2. Më 8 mars 2006, Gjykata e Rrethit Vlorë (Gjykata e Rrethit) e shpalli kërkuesin fajtor për vrasje, të kryer në bashkëpunim me të tjerë, dhe për mbajtje të paligjshme të armëve të zjarrit. Ajo e dënoi atë me 25 vjet burgim.

3. Pasi çështja u ridërgua disa herë për shqyrtim, më 18 qershor 2014, Gjykata e Apelit Vlorë uli dënimin e dhënë nga Gjykata e Rrethit, më 8 mars 2006, për veprën penale të mbajtjes së paligjshme të armëve të zjarrit, por la në fuqi dënimin e përbashkët të dhënë nga Gjykata e Rrethit. Dënimi total me burgim i kërkuesit prej 25 vjetësh mbeti i pandryshuar. Më 5 nëntor 2015, Gjykata e Lartë rrëzoi një ankim kasacioni nga kërkuesi pasi ai nuk kishte paraqitur asnjë bazë të argumentueshme mbi të cilën mund të bazohej një ankim mbi pikat e ligjit.

4. Më 4 gusht 2016, Gjykata Kushtetuese, e mbledhur në një formacion prej shtatë nga nëntë gjyqtarësh, pasi dy gjyqtarë u tërhoqën nga shqyrtimi i çështjes, e rrëzoi pa paragjykim ankesën e kërkuesit për mosarritjen e shumicës së kërkuar prej pesë anëtarësh. Arsyetimi në vendim u kufizua në deklarin e rezultateve të votimit (katër vota kundër tre në favor të rrëzimit të ankesës kushtetuese) dhe faktin se gjykata nuk kishte qenë në gjendje të arrinte shumicën e kërkuar prej pesë anëtarësh për asnjë nga çështjet e ngritura në ankesë.

5. Kërkuesi u informua për mundësinë, sipas nenit 74 të Ligjit të Gjykatës Kushtetuese, për të paraqitur një ankesë të re në një datë të mëvonshme.

LIGJI DHE PRAKTIKA E BRENDASHME

6. Në çështjen *Marini kundër Shqipërisë* (nr. 3738/02, 18 dhjetor 2007), Gjykata vendosi se rrëzimi i një ankesë kushtetuese pa paragjykim, me arsyetimin se gjykata nuk kishte arritur “shumicën e kërkuar të votave të të gjithë anëtarëve për asnjë nga rezultatet”, kishte shkelur të drejtën për një gjykim të drejtë. Pas këtij vendimi, ligji nr. 99/2016, që hyri në fuqi më 1 mars 2017, ndryshoi nenin 73(4) të Ligjit të Gjykatës Kushtetuese. Në përputhje me këto ndryshime, nuk është më e mundur që të rrëzohet pa paragjykim një ankesë individuale si pasojë e mosarritjes së shumicës prej pesë anëtarësh. Në raste të tilla, ankesa do të rrëzohet me paragjykim në mënyrë përfundimtare dhe definitive. Neni i mëparshëm 74 i Ligjit të Gjykatës Kushtetuese, që parashikonte mundësinë e paraqitjes së një ankesë të re në raste të tilla, u shfuqizua.

VLERËSIMI I GJYKATËS

I. SHKELJA E PRETENDUAR E NENIT 6 §1 TË KONVENTËS, NË LIDHJE ME TË DREJTËN PËR T'IU DREJTUAR GJYKATËS KUSHTETUESE

7. Gjykata vëren se kjo ankesë nuk është qartazi e pabazuar sipas interpretimit të nenit 35 § 3 (a) të Konventës, dhe as nuk është e papranueshme për ndonjë arsye tjetër. Prandaj, ajo duhet të shpallet e pranueshme.

8. Parimet e përgjithshme, në lidhje me aksesin në Gjykatën Kushtetuese të Shqipërisë për sa i përket rrëzimit të ankesave kushtetuese për shkak se nuk mund të arrihej shumica – para ndryshimeve të bëra nga ligji nr. 99/2016 (shih paragrafin 6 më sipër) – janë përmbledhur në vendimin *Marini* (cituar më sipër, §§ 118–23).

9. Kërkuesi argumentoi se ai ishte privuar nga aksesin në Gjykatën Kushtetuese, pasi ajo nuk kishte arritur shumicën e kërkuar prej pesë anëtarësh. Një qasje e tillë e kishte lënë atë pa një vendim përfundimtar të pretendimeve të tij dhe kishte shkelur garancitë e gjyqimit të drejtë sipas Konventës.

10. Qeveria pretendoi se rrëzimi i çështjes për shkak të mosarritjes së shumicës së kërkuar prej pesë anëtarësh ishte bazuar në ligjin në fuqi në kohën përkatëse dhe kishte për qëllim sigurimin e konsistencës së praktikës gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese dhe miratimin e vendimeve të mbështetura në fakte.



11. Gjykata nuk gjen argumente të forta për të dalluar çështjen aktuale nga çështja *Marini*. Ankesa kushtetuese e kërkuarit u rrëzua sepse anëtarët e panelit ishin të ndarë dhe nuk mundën të arrinin shumicën prej pesë anëtarësh të kërkuar me ligj. Kjo e la kërkuarin pa një vendim përfundimtar të çështjes së tij dhe, në përputhje me rrethanat, kufizoi të drejtën e tij për t'iu drejtuar Gjykatës Kushtetuese (krahajo *Marini*, cituar më sipër, § 122, dhe *Prodhim Veshje nr. 2 sh.a. kundër Shqipërisë*, [Komiteti], nr. 34649/14, § 10, 17 tetor 2023). Nuk kishte asnjë mundësi të afërt që situata të ndryshonte, pasi dy nga gjyqtarët ishin vetëpërfshirë për shkak të pjesëmarrjes së tyre të mëparshme në Trupin Gjykoës të Gjykatës së Lartë që gjykonte çështjen në fjalë. Në këto rrethana, Gjykata vlerëson se vendimi i kontestuar i Gjykatës Kushtetuese, i cili e rrëzoi kërkesën kushtetuese të kërkuarit si pasojë e mosarritjes së shumicës së kërkuar prej pesë anëtarësh, përbënte një mohim të pajustificuar të së drejtës së kërkuarit për t'iu drejtuar Gjykatës Kushtetuese.

12. Për këtë arsye, është shkelur neni 6 §1 i Konventës.

II. SHKELJE TË TJERA TË PRETENDUARA SIPAS PRAKTIKËS GJYQËSORE TË KONSOLIDUAR

13. Kërkuari paraqiti, gjithashtu, ankesa të tjera sipas nenit 6 §§1, 2 dhe 3 të Konventës.

14. Duke pasur parasysh gjetjet e saj, në lidhje me të drejtën e kërkuarit për t'iu drejtuar gjykatës sipas nenit 6 §1 të Konventës (shih paragrafin 12 më sipër), Gjykata vëren se kërkuari tani ka një mundësi për të kërkuar rihapjen e procedurave në Gjykatën Kushtetuese (shih paragrafin 17 në vijim). Kjo do të lejonte, në parim, një shqyrtim gjithëpërfshirës të ankesave të mbetura të kërkuarit sipas Konventës. Në këto rrethana, dhe në përputhje me rolin e saj ndihmues, Gjykata konsideron se nuk është e nevojshme të shqyrtojë ankesat e mbetura të kërkuarit në këtë kohë. Ai është i hapur për të paraqitur një kërkesë të re në Gjykatë, sipas rastit, pas një vendimi të ri të ankesës së tij kushtetuese në nivel kombëtar.

ZBATIMI I NENIT 41 TË KONVENTËS

15. Kërkuari kërkoj 45,000 euro (EUR) në lidhje për dëmin jomaterial dhe 15,000 euro për kostot dhe shpenzimet në gjykatat vendase dhe 12,685 euro për ato para Gjykatës.

16. Qeveria argumentoi se pretendimet ishin të pabazuara dhe të tepërta.

17. Gjykata përsërit se një vendim në të cilin ajo konstaton një shkelje i imponon shtetit të paditur një detyrim ligjor për t'i dhënë fund shkeljes dhe për të bërë dëmshpërblim për pasojat e saj. Duke pasur parasysh natyrën e ankesës së kërkuarit dhe shkeljen e konstatuar, Gjykata vlerëson se forma më e përshtatshme e dëmshpërblimit në rastin konkret do të ishte rihapja e procedurave penale kundër kërkuarit, nëse ai e kërkon këtë (krahajo *Shkalla kundër Shqipërisë*, nr. 26866/05, §§ 77–79, 10 maj 2011, dhe *Meli kundër Shqipërisë*, nr. 41373/21 dhe 48801/21, § 83, 16 korrik 2024).

18. Gjykata vlerëson se kërkuari duhet të ketë pësuar dëme jomateriale si rezultat i shkeljes së gjetur. Duke bërë vlerësimin e saj mbi baza të barabarta, siç kërkohet nga neni 41 i Konventës, ajo i akordon kërkuarit 3,600 euro në lidhje me dëmin jomaterial.

19. Duke pasur parasysh dokumentet në zotërim të saj, Gjykata e vlerëson të arsyeshme të akordojë 2,500 euro që mbulojnë shpenzimet e bëra në procedurat para Gjykatës dhe në gjykatat vendase, plus çdo taksë që mund t'i tarifohet kërkuarit.

PËR KËTO ARSYE, GJYKATA, NË MËNYRË UNANIME,

1. *E shpall* të pranueshme ankesën, në lidhje me të drejtën e kërkuarit për t'iu drejtuar Gjykatës Kushtetuese;

2. *Gjykon* se është shkelur neni 6 §1 i Konventës, në lidhje me aksesin në Gjykatën Kushtetuese;

3. *Gjykon* se nuk është e nevojshme të shqyrtohen pranueshmëria dhe meritat e ankesave të tjera;

4. *Gjykon*

a) se shteti i paditur duhet t'i paguajë kërkuarit brenda tre muajve shumat e mëposhtme, që duhet të konvertohen në monedhën e shtetit të paditur, në normën e zbatueshme në datën e shlyerjes:

i. 3,600 euro (tre mijë e gjashtëqind euro), plus çdo taksë që mund të tarifohet për dëmin jomaterial;

ii. 2,500 euro (dy mijë e pesëqind euro), plus çdo taksë që mund t'i tarifohet kërkuarit për kostot dhe shpenzimet;

b) se që nga përfundimi i periudhës tremujore të sipërpërmendur deri në shlyerje, interesi i thjeshtë do të duhet të paguhet për shumat e mësipërme në normën e barasvlershme me normën marginale të huadhënies së Bankës Qendrore Evropiane gjatë periudhës së mosshlyerjes plus tre pikë përqindje.



5. *Rrëzohet* pjesën tjetër të kërkesës së kërkuarit për shpërblim të drejtë.

Hartuar në anglisht dhe njoftuar me shkrim më 5 maj 2026, në mbështetje të Rregullit 77 §§ 2 dhe 3 të Rregullores së Gjykatës.

Olga Chernishova
ZËVENDËSEKRETARE

Úna Ní Raifeartaigh
KRYETAR

GJYKATA EVROPIANE E TË DREJTAVE
TË NJERIUT
SEKSIONI I TRETË

ÇËSHTJA METALLA KUNDËR SHQIPËRISË

(Kërkesa nr. 19646/20)

VENDIM

STRASBURG

5 maj 2026

*Ky është vendim përfundimtar, por mund t'i nënshtrohet
rishikimit redaktorial.*

Në çështjen Metalla kundër Shqipërisë,

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (Seksioni i Tretë), e mbledhur si Komitet i përbërë nga:

Úna Ní Raifeartaigh, *kryetar,*

Darian Pavli,

Mateja Đurović, *gjyqtarë,*

dhe Olga Chernishova, *Zëvendëskancelar i Seksionit,*
Duke pasur parasysh:

kërkesën (nr. 19646/20) kundër Republikës së Shqipërisë të depozituar në Gjykatë sipas nenit 34 të Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut ("Konventa") më 7 maj 2020 nga shtetasi shqiptar z. Ervin Metalla ("kërkuar"), i lindur në vitin 1976, me banim në Tiranë dhe i përfaqësuar nga znj. T. Eatwell dhe që nga viti 2021 nga z. S. Powles, avokatë që ushtrojnë profesionin e tyre në Londër;

vendimin për të njoftuar Qeverinë e Shqipërisë ("Qeveria") të përfaqësuar nga z. O. Moçka, Avokat i Përgjithshëm Shtetit, për ankimin në lidhje me të drejtën e kërkuarit për respektimin e jetës private

dhe për të shpallur të papranueshme pjesën tjetër të kërkesës;

parashtrimet e palëve;

vendimin për të refuzuar kërkesën e kërkuarit për një seancë dëgjimore (Rregulli 59 § 3 i Rregullores së Gjykatës);

Pas diskutimit me dyer të mbyllura më 31 mars 2026,

mori vendimin e mëposhtëm, i cili u miratua po në këtë datë:

OBJEKTI I ÇËSHTJES

1. Çështja ka të bëjë me shkarkimin e kërkuarit nga detyra nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (KPK) dhe Kolegji i Posaçëm i Apelit (KPA) sipas Ligjit për Vetingun (LV) (shihni *Xhoxhaj kundër Shqipërisë*, nr. 15227/19, 9 shkurt 2021).

2. Kërkuar ka shërbyer si gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës nga viti 2001, si kryetar i saj nga viti 2005 dhe si gjyqtar në Gjykatën e Apelit Tiranë nga viti 2013. Gjithashtu, ai ishte kryetar i Unionit të Gjyqtarëve nga viti 2011.

3. Institucionet që ndihmojnë KPK-në nuk identifikuan probleme për lidhjet me krimin e organizuar, apo aftësitë e tij profesionale dhe përmbushjen e kërkesave të përgjithshme etike (shihni *Xhoxhaj*, cituar më lart, §§ 138-43). KPK-ja refuzoi të kryejë hetimin në lidhje me këto kritere, ndryshe nga kërkesa e kërkuarit.

4. Më 23 korrik 2018, KPK-ja e shkarkoi kërkuarin sipas nenit 61 paragrafi 3 të LV-së, për shkak të parregullsive që lidhen me pasurinë e vëllait të tij E.M. dhe deklaratimit të pasurive të kërkuarit. Ajo theksoi se standardet etike kërkojnë që gjyqtarët të veprojnë me integritet në veprimtarinë jashtëgjyqësore dhe në mënyrë që kontribuon në detyrat e tyre. Sjellja e kërkuarit nuk kishte qenë etike, sepse ai ka qenë i përfshirë në transaksione fiktive.

5. Kërkuar e ankmoi dhe e përsëriti kërkesën e tij për një vlerësim në lidhje me kriteret e tjera, të cilat, sipas tij, do të kishin treguar kontributin e tij në sistemin e drejtësisë përmes mësimdhënies, manualeve për profesionistët e ligjit dhe mbajtjes së kryesisë së Unionit të Gjyqtarëve.

6. Më 30 tetor 2019, KPA-ja la në fuqi gjetjet e KPK-së me shumicën e votave 3 me 2 dhe zbatoi një shkak shtesë sipas paragrafit 5 të nenit 61 të LV-së, i cili parashikonte shkarkimin nëse pas një vlerësimi të përgjithshëm të të gjitha kriterëve të vlerësimit ose "një vlerësimi të përgjithshëm të



procedurave”, rezulton se subjekti i vetëgut ka cenuar besimin e publikut të sistemi i drejtësisë. KPA-ja u shpreh si më poshtë:

a) Kërkuesi kishte jetuar në apartament me qira në Tiranë dhe udhëtonte për të shkuar në punë në Durrës. Ai kishte nënshkruar një kontratë paraprake shitjeje dhe një kontratë huaje tregtare në vitin 2007 dhe e kishte blerë apartamentin, pronësia e të cilit do t'i kalohej atij pas legalizimit dhe regjistrimit në emër të shitësit, i cili kishte ndodhur në vitin 2013.

b) Nga viti 2008 dhe më tej, sipas vendimit të Këshillit të Ministrave (VKM) nr. 600/2007, gjyqtarët lejoheshin të merrnin një kredi të butë – me mbi 4% interes të mbuluar nga shteti – nëse ata apo familjarët e tyre nuk kishin në pronësi një banesë në rrethin e tyre gjyqësor. Kredia kufizohej vetëm për strehim në atë rreth.

c) Në vitin 2011, anekset e kontratave të vitit 2007 e zëvendësonin kërkuesin me E.M. si blerës dhe debitor. Kërkuesi e pranoi këtë me qëllim që të përfitonte kredinë e butë. KPA-ja u shpreh që kjo kishte krijuar idenë që ai nuk e kishte më pronësinë mbi apartamentin, edhe pse kishte vazhduar të jetonte në të. Aneksi i kontratës së shitjes as nuk ishte noterizuar as nuk ishte deklaruar në deklarimin e tij të pasurisë në vitin 2011.

d) Kërkuesi e kishte nënshkruar deklarimin në përputhje me VKM-në, një kontratë për blerjen e një apartamenti në Durrës dhe një kontratë për kredi të butë në shumën 5,000,000 lekë (ALL), ku E.M. vepronte si dorëzan. Sipas kontratës së hipotekimit, E.M. e kishte ofruar apartamentin (e blerë në vitin 2008) si kolateral. Nëpërmjet disa transaksioneve, kredia e butë ishte transferuar në llogarinë e babait të tij N.M. si “shlyerje borxhi”. Edhe pse fondet ishin në dispozicion të kërkuesit, ai nuk i kishte deklaruar si likuiditet në deklarimin e tij të pasurisë në vitin 2011.

e) Në vitin 2012, kërkuesi, N.M. dhe të tjerë nënshkruan marrëveshje për shkëmbim borxhi në mënyrë që shuma prej 5,000,000 lekësh të përdorej për të blerë një apartament të ri në Tiranë. Kërkuesi e kishte deklaruar synimin e tij për ta blerë dhe N.M. kishte deklaruar që fondet ishin të kërkuesit. Kërkuesi ishte tërhequr nga kontrata për Durrësin, me pretendimin e vonësive në ndërtim. KPA-ja vlerësoi se qëllimi i vetëm i kontratës për Durrësin ishte përmbushja e kushteve për kredi të butë. Ai kishte nënshkruar një kontratë paraprake për atë apartament të ri në Tiranë, por nuk e kishte

deklaruar në deklarimin e pasurisë së vitit 2012. Në vitin 2013, kërkuesi E.M. dhe një agjenci e pasurive të paluajtshme kishin rënë dakord që apartamenti i ri t'i kalohej E.M., ndërsa apartamenti i vitit 2007 t'i mbetej kërkuesit, ku secili do të paguante “kredinë përkatëse”.

7. KPA-ja vlerësoi në veçanti që kërkuesi kishte marrë masa: i. për të fshehur ose paraqitur në mënyrë të pasaktë përdorimin prej tij të apartamentit të vitit 2007, duke përfutur nga kredia e butë; dhe ii. për të lejuar dhënien e pasaktësive në lidhje me likuiditetin e tij në deklarimin e tij të vitit 2011.

8. KPA-ja gjeti që kërkuesi, duke mos respektuar ligjin, kishte marrë një kredi të butë në shkelje të kriterëve ligjore dhe dukej se e kishte përdorur për apartamentin në Tiranë në vitin 2007 ku vazhdoi të jetonte, dhe jo për banesën në Durrës. Sjellja jashtëgjyqësore u udhëhoq nga Parimet e Bangalorit të Sjelljes Gjyqësore dhe, sipas Kodit shqiptar të Etikës Gjyqësore 2006, gjyqtarët duhet të sigurohen që veprimtaritë e tyre jashtëgjyqësore të mos cenojnë autoritetin e gjyqësorit. Transaksionet fiktive për përfitim personal ishin joetike dhe kishin cenuar besimin e publikut në sistemin e drejtësisë.

9. Në fund, kërkuesi nuk arriti të provonte që E.M. kishte pasur mjaftueshëm burime të ligjshme të fondeve.

a) Neni 3, pika 14, i LV-së përkufizon “persona të tjerë të lidhur” si çdo person i cili ka me subjektin një marrëdhënie interesi që lind nga interesi pasuror ose marrëdhënia e biznesit. Sipas nenit 32 pika 4, nga subjektet e vetëgut, personat e tyre të lidhur ose “çdo person i lidhur” të deklaruar si dhurues, huadhënës ose huamarrës kërkohet që të provojnë origjinën e ligjshme të pasurive të tyre.

b) KPK-ja e zhvendosi barrën e provës te kërkuesi sepse E.M.: i. e kishte zëvendësuar si debitor dhe blerës të apartamentit në Tiranë në vitin 2007; ii. i kishte paguar atij shumën 1,000,000 në vitin 2011, një pjesë të së cilës ai tashmë e kishte shlyer në bankë ndërmjet 2008-11; dhe për shkak të shitjes së automjetit në vitin 2014. Në vendimin e tij të 23 korrikut 2018, KPK-ja kishte cituar (i) dhe (ii) kishte theksuar që kërkuesi kishte vazhduar të jetonte në apartament në periudhën 2011-13 dhe prandaj ekzistonte marrëdhënia huadhënës-huamarrës, dhe i ishte referuar kolateralit të E.M.

c) KPA-ja u shpreh që E.M. kishte mbajtur një marrëdhënie juridike të vazhdueshme në interes të njëanshëm të kërkuesit, duke supozuar kushte



financiare më pak të favorshme në vitet 2007-13. E.M. ishte bërë dorëzan i kredisë së butë; sipas rregullave të dorëzansë së Kodit Civil, dorëzanësi siguron ekzekutimin e detyrimit të debitorit dhe përgjigjet për aq sa detyrohet debitori kryesor. Prandaj, ekzistonte një lidhje interesi. Kërkuesi kishte marrë, gjithashtu, një hua nga E.M. në vitin 2004 dhe 1,000,000 lekë në vitin 2011 dhe kishte vazhduar të përdorte apartamentin në Tiranë pas kalimit të të drejtave të tij. Të lexuara së bashku, nenet 3(14) dhe 32(4) nënkuptonin që E.M. cilësohej si “person tjetër i lidhur”.

d) Prandaj, kërkuesi duhej të provonte që E.M. kishte marrë të ardhura të ligjshme gjatë qëndrimit të tij në Itali nga fundi i viteve 1990 deri në vitin 2008 (të përdorura për apartamentin e vitit 2008 të ofruar më vonë si kolateral dhe për huan e vitit 2004), dhe në Shqipëri për shumën prej 1,000,000 lekësh. Të dhënat treguan, në veçanti, se të ardhurat e E.M. nga jashtë vendit kishin qenë shumë modeste.

10. Dy gjyqtarë të KPA-së shprehën mendim pakice, duke mos u pajtuar me gjetjet e shumicës në lidhje me etikën, interpretimin e ligjit të brendshëm në lidhje me E.M. dhe marrëdhëniet e kërkuesit me të, duke përfshirë edhe gjetjen që transaksionet kishin qenë “fiktive”.

VLERËSIMI I GJYKATËS

I. PRANUESHMËRIA

11. Duke pasur parasysh praktikën gjyqësore të Gjykatës (shihni *Masse kundër Francës* (vend.), nr. 47506/20, §§ 20-32, 25 mars 2025), kjo kërkesë nuk duhet të refuzohet me arsyetimin që është jashtë afatit. Ajo nuk është haptazi e pabazuar sipas kuptimit të nenit 35 paragrafi 3 (a) të Konventës ose e papranueshme për ndonjë shkak tjetër. Prandaj, kërkesa duhet të shpallet e pranueshme.

II. THEMELI

A. Parashtrimet e palëve

1. Kërkuesi

12. Kërkuesi pretendoi se shkarkimi i tij nga detyra ishte joproporcional dhe përbënte shkelje të nenit 8 të Konventës. Ai këmbënguli se transaksionet e tij kishin qenë të ligjshme. Kur kishte marrë kredinë e butë, ai kishte pasur vetëm një kontratë për të blerë një apartament me kredi tregtare dhe nuk kishte asnjë banesë në pronësi. Ai e kishte përdorur kredinë e butë për një apartament në Durrës, por e kishte zgjidhur atë kontratë për shkak të vonësive në ndërtim dhe angazhimeve të tij në rritje në Tiranë si Kryetar i Unionit të

Gjyqtarëve që nga viti 2011. Kredinë e butë e kishte përdorur për një apartament në Tiranë, i cili ishte vetëm 30 minuta larg me makinë nga Durrësi. Në vitin 2013 u transferua në Tiranë. Qëllimi i kredisë së butë kishte qenë gjithmonë financimi i një apartamenti brenda juridiksionit të mandatit të tij; apartamenti në fjalë kishte ndryshuar ndërmjet viteve 2011 dhe 2013, ashtu si edhe pozicioni i tij në gjyqësor.

13. Kodi i Etikës kërkonte kujdes për aktivitetet jashtëgjyqësore, të cilat duhej të vlerësoheshin në lidhje me pasojat ndaj paanshmërisë ose ndërhyrjes në detyrat gjyqësore. Ligji nr. 9877/2008 i cilëson si shkelje të rënda disiplinore veprimtari të tilla, si: përfshirja në aktivitet politik, menaxhimi i kompanive, bërja e deklaratave publike në lidhje me çështjet në shqyrtim ose cenimi i paanshmërisë ose dinjitetit gjyqësor. KPA-ja nuk e shpjegoi se si veprimet e kërkuesit kishin cenuar autoritetin e gjyqësorit. Shkelja etike nuk përbënte shkak për shkarkim, por mund t'i nxiste organet e vetëgjyqësorisë që ta referonin çështjen për procese të zakonshme disiplinore.

14. Kërkesa për të provuar burimet e ligjshme mbulonte pasuritë që i përkisnin familjes së ngushtë të subjektit të vetëgjyqësorisë dhe kreditë ose donacionet nga palë të treta. Një palë e tretë mund të konsiderohej “e lidhur” me subjektin e vetëgjyqësorisë, vetëm nëse kishte prova të një përfitimi të njëanshëm pasuror, duke përfshirë fshehjen e pasurive të subjektit të vetëgjyqësorisë, mbajtjen e pasurive në emër të tij ose të saj, ose marrjen e fitimeve nga prona të lidhura me të. Zgjerimi i detyrimit përtej këtyre situatave do të kërkonte që subjekti i vetëgjyqësorisë, për shembull, të provonte ligjshmërinë e kapitalit në bankë, sepse ai ose ajo kishte marrë një kredi. Disa vendime përfundimtare të KPK-së në vitet 2018-19 nuk e kishin trajtuar marrëdhënien e hipotekimit si të mjaftueshme për të klasifikuar një palë të tretë si “person tjetër i lidhur”. Në korrik 2019, KPA-ja kishte treguar nevojën për një interpretim kufizues të nenit 32(4) të LV-së dhe e ndoqi këtë qasje në raste të krahasueshme pas çështjes së kërkuesit.

15. Garancia hipotekare e E.M. dhe shlyerja prej tij e shumës 1,000,000 lekësh nuk ishin as dhuratë dhe as hua. Nuk kishte pasur asnjë marrëdhënie biznesi, asnjë konflikt interesi dhe asnjë të dhënë që pasuritë e E.M. i përkisnin kërkuesit ose që gëzoheshin prej tij ose ishin fshehur në emër të tij. Kërkesa që kërkuesi të justifikonte të ardhurat e



huaja të E.M. nga fundi i viteve 1990 e më tej, dhe shkarkimi i tij për mungesë dokumentacioni bashkëkohor, ishin të paligjshme dhe joproporcionale. Asgjë nuk sugjeronte se të ardhurat e E.M. kishin qenë të paligjshme; autoritetet italiane kishin dokumentuar në mënyrë të besueshme të ardhurat e tij për vitin 2001-06 dhe kishin shpjeguar pamundësinë e ofrimit të të dhënave të mëparshme. Pjesa më e madhe e këtyre të ardhurave ishte fituar përpara se kërkuesi të bëhej subjekt raportimi dhe ai nuk kishte përfituar prej tyre.

2. Qeveria

16. Qeveria konfirmoi gjetjet e KPA-së dhe tregoi se përfundimet e saj në lidhje me etikën kishin qenë një bazë vendimtare dhe e pavarur për shkarkimin e kërkuesit. Gjithashtu, ai kishte ndërmarrë hapa për të fshehur ose treguar në mënyrë të pasaktë përdorimin e apartamentit në Tiranë nga ana e tij. Marrëdhëniet e tij të shumëfishta me E.M. kishin shkuar përtej marrëdhënieve të zakonshme familjare dhe kishin krijuar një lidhje të qëndrueshme ekonomike, e cila kishte qenë e mjaftueshme sipas jurisprudencës së konsoliduar për të shkaktuar detyrimin për të justifikuar pasuritë e vëllait të tij. KPA-ja kishte pranuar prova të reja, kishte ngushtuar barrën e provës për të mbuluar fondet e përdorura nga E.M. për të blerë apartamentin e tij në vitin 2008 dhe për 1,000,000 lekë, dhe kishte vlerësuar plotësisht faktet.

B. Vlerësimi i Gjykatës

17. Shkarkimi i kërkuesit përbën ndërhyje në të drejtën e tij për respektimin e jetës private dhe shkelje të nenit 8 të Konventës nëse nuk justifikohet se është në përputhje me ligjin dhe i nevojshëm në një shoqëri demokratike për të ndjekur një qëllim legjitim (shihni *Thanza kundër Shqipërisë*, nr. 41047/19, §§ 135 dhe 137, 4 korrik 2023).

18. Së pari, nëse interpretimi i legjislacionit të brendshëm nga gjykatat nuk është arbitrar ose haptazi i paarsyeshëm, roli i Gjykatës kufizohet në përcaktimin nëse pasojat e atij interpretimi janë në përputhje me Konventën (shihni *Danileț kundër Rumanisë* [DHM], nr. 16915/21, § 123, 15 dhjetor 2025). Lidhur me pamundësinë e tij për të justifikuar pasuritë e E.M. dhe në veçanti apartamentin e përdorur si kolateral në një transaksion pasurie të paluajtshme (shihni paragrafin 9 më sipër), kërkuesi pretendoi se kredia hipotekore e E.M. nuk duhej të kishte krijuar detyrimin sipas nenit 32(4) të LV-së (shihni paragrafët 5 dhe 14 më sipër). Qeveria nuk

citoi asnjë praktikë gjyqësore që të provonte të kundërtën.

19. Gjykata vëren se përkufizimi “person tjetër i lidhur” sipas nenit 3 (14) të LV-së është formuluar në terma mjaft të gjera që mund të zbatohen për një rreth të gjerë personash me të cilët subjektet e vetingut mund të kenë pasur marrëdhënie që kanë rezultuar në njëfarë përfitimi personal, edhe kur këto marrëdhënie nuk janë domosdoshmërisht të një natyre të qartë pasurore. Kjo bie ndesh me përkufizimin e përfshirë në nenin 32(4), i cili lidhet me dhuruesit, huadhënësit dhe huamarrësit. Për më tepër, përkufizimi në fjalë kërkon zbatim të kujdesshëm pasi mund të vendosë një barrë të rëndë mbi subjektin e vetingut për të provuar ligjshmërinë dhe mjaftueshmërinë e të ardhurave të një personi tjetër në lidhje me rrethanat që datojnë shumë vite më parë. Subjekti i vetingut mund të duhet ta bëjë këtë në mungesë të ndonjë detyrimi ligjor bashkëkohor për këtë qëllim, duke ngritur ndoshta pyetje për parashikueshmërinë. Megjithatë, Gjykata nuk ka nevojë të dalë në një përfundim të prerë nëse ndërhyrja ishte “në përputhje me ligjin”, sepse, sidoqoftë, nuk u tregua bindshëm se ajo ishte proporcionale me qëllimet legjitime (shihni, në këtë drejtim, *Sevdari kundër Shqipërisë*, nr. 40662/19, §§ 73-79, 13 dhjetor 2022) për arsyet e përmendura më poshtë.

20. Shkarkimi nga detyra – veçanërisht i gjyqtarëve që gëzojnë mandat të përjetshëm – është një masë disiplinore e rëndë, për të mos thënë më e rënda e cila kërkon vlerësimin e provave të forta që lidhen me etikën, integritetin dhe kompetencën profesionale të individit (ibid., § 86). Gjyqësori duhet të gëzojë besimin e publikut dhe – aty ku standardet etike dhe rregullat që rregullojnë shkeljet disiplinore konvergojnë në lidhje me sjelljen jashtëgjyqësore që mund të cenojë besimin e publikut – duhet të ketë një kriter kufi për të dalluar shkeljen e rëndë disiplinore që mund të justifikojë masa disiplinore nga format e tjera të sjelljeve të papërshtatshme (shihni *Danileț*, cituar më sipër, §§ 134 dhe 138). Neni 61(5) i LV-së normalisht duhet të interpretohet së bashku me rregulla të tjera disiplinore më specifike që ishin në fuqi në kohën përkatëse dhe të cilat ndëshkonin shkeljet me natyrë etike ose profesionale; çdo përfundim që një gjyqtar ka cenuar besimin e publikut duhet të mbështetet me arsye të mjaftueshme (shihni *Xboxhaj*, §§ 387 dhe 410, dhe *Sevdari*, § 94, të dyja të cituara më sipër).



21. Sa u përket veprimtarive jashtëgjyqësore, legjislacioni në fuqi në atë kohë fokusohet në ndalime specifike. Ai, gjithashtu, përmbante një detyrim të gjerë etik për të mos cenuar autoritetin e gjyqësorit, i cili pasqyronte Kodin e Etikës (shihni paragrafët 8 dhe 13 më sipër). Megjithatë, duke pasur parasysh faktet e kësaj çështjeje, nuk është e qartë nëse ndonjë shkelje etike që i është ngarkuar kërkuetit për kryerjen e punëve të tij private ka arritur kufirin e rëndesës që do të kishte justifikuar masën më të rëndë disiplinore, sipas kushteve të legjislacionit të brendshëm në fuqi në atë kohë.

22. Vlerësimi i pasurive përcaktoi nëse një magjistrat kishte deklaruar me saktësi të gjitha pasuritë dhe nëse këto pasuri kishin origjinën nga të ardhura të ligjshme dhe të deklaruara, duke identifikuar, gjithashtu, çdo pasuri të pajustificuar, pasuri të fshehur ose të deklaruar gabim, ose konflikt interesi (shihni *Xboxhaj*, i cituar më sipër, § 137). Asnjë gjykatë civile nuk ka gjetur që transaksionet e kërkuetit ishin fiktive, as nuk është ngritur ndonjë padi në lidhje me to – duke përfshirë edhe në lidhje me avantazhin e fituar nga kërkueti për shkak të diferencës së normës së interesit sipas kushteve të kredisë së butë.

23. Gjykata vëren se disa nga transaksionet e kërkuetit në lidhje me apartamentet mund të ngrenë pyetje legjitime të sjelljes etike për një gjyqtar të lartë, duke përfshirë edhe nëse ata i kanë respektuar rregullat për kreditë e buta. Megjithatë, KPA-ja kishte të drejtë t'ua referonte këto shqetësime organeve disiplinore për të vlerësuar sanksionet e duhura përveç shkarkimit të plotë (shihni *Sevdari*, cituar më sipër, § 95).

24. Parregullsia e pretenduar e sjelljes së kërkuetit në lidhje me kredinë e butë dhe pasojat etike që i atribuohen asaj nuk mund të karakterizohen si mjaftueshëm të rënda dhe të afta, në vetvete, për të justifikuar përfundimet e gjera të KPA-së, të cilat, pas çështjes së vetingut, gjithashtu, sollën largimin e përhershëm nga gjyqësori. Bazuar në faktet e çështjes, as sjellja në fjalë nuk zbuloi ndonjë konflikt interesi ose nuk lidhej me luftën kundër korrupsionit, i cili ishte një nga arsyet kryesore në themel të procesit të vetingut (shihni *Xboxhaj*, § 299, dhe *Sevdari*, §§ 78-79, të dyja të cituara më sipër).

25. Duke qenë kështu, përfundimi i KPA-së nuk bazohej në një vlerësim global të të dhënave profesionale dhe etike të kërkuetit gjatë karrierës së tij të konsiderueshme gjyqësore (krahasoni *Sevdari*, §

88; *Xboxhaj*, §§ 37-40 dhe 410; dhe *Thanza*, §§ 29-33 dhe 47, të gjitha të cituara më sipër). KPA nuk arriti të ndiqte vlerësimin e proporcionalitetit dhe të përcaktonte nëse sjellja në fjalë pasqyronte, për shembull, një model të shkeljes së rëndë. Në mungesë të një hetimi më gjithëpërfshirës dhe një analize të mirëformuluar të parametrit, vendimi që kërkueti kishte cenuar besimin e publikut mbështetej në një bazë faktike të paplotë dhe një justifikim të pamjaftueshëm ligjor. Prandaj, nuk tregoi në mënyrë bindëse që vazhdimi i mandatit të tij ishte i papranueshëm. Për më tepër, KPA-ja nuk e njoftoi kërkuetin paraprakisht që do t'i ricilësonte elementet e shqyrtuar nga KPK-ja si të përfshirë nën kategorinë e cenimit të besimit publik në sistemin e drejtësisë (shihni paragrafët 4-6 më sipër).

26. Së dyti, në lidhje me mosjustifikimin nga kërkueti të fondeve të E.M., nuk u tregua as që qasja e KPA-së ishte proporcionale në rrethanat e çështjes.

27. LV-ja përcaktoi në mënyrë të qartë detyrimin për të justifikuar fondet e përdorura nga një huadhënës ose dhurues si kredi ose dhuratë. Gjithashtu, është e mundur që në disa kontekste të tjera të lindin dyshime të arsyeshme se shkelje të rënda – të tilla si fshehja e një pasurie, marrja e një përfitimi të padrejtë ose një konflikt interesi – mund të jenë kryer me ndihmën e palëve të treta. Megjithatë, asnjë nga këto rrethana nuk identifikohet nga vendimi i KPA-së në çështjen në fjalë (shihni paragrafin 9(c) – (d) më sipër).

28. Kolaterali i E.M. dhe shlyerja prej tij e shumës prej 1,000,000 lekësh as nuk e pasuruan kërkuetin dhe as nuk i rritën pasuritë e tij, dhe ato nuk i dhanë ndonjë avantazh pasuror të ngjashëm me një dhurim apo kredi. Asnjë gjë nuk tregon se kolaterali shkoj përtej një favorit të zakonshëm nga vëllai ose motra për të lehtësuar kredinë. Vendimi i KPK-së, i cili shkaktoi detyrimin e kërkuetit për të justifikuar gjendjen financiare të E.M. bazohej edhe në fakte të tjera (shihni paragrafin 9 (b) më sipër), por nuk duket se ka pasur ndonjë kërkesë ligjore në kohën në fjalë, ose ndonjë tregues konkret se pasuritë e lart përmendura kishin origjinë të paligjshme, ose përndryshe të dyshimtë, që do ta kishte detyruar kërkuetin të vepronte me më shumë kujdes.

29. Kështu, edhe nëse supozohet se detyrimi për të justifikuar fondet e vëllait për apartamentin e këtij të fundit ishte në përputhje me ligjin kombëtar (shihni paragrafët 18–19 më sipër), barra e rëndë e



vendosur mbi kërkuesin gjatë procesit të vetingut kërkonte një justifikim bindës (krahasoni *Sevdari*, cituar më sipër, § 88). Gjithashtu, arsyetimet në ndryshim të përdorura nga organet e vetingut për të klasifikuar E.M., si “person tjetër i lidhur” – dhe zgjerimi përkatës i objektit të këtij detyrimi – shtuan barrën joproporcionale të vendosur mbi kërkuesin, i cili në fund të fundit duhej të justifikonte një pjesë të konsiderueshme të të ardhurave të E.M. gjatë një periudhe të zgjatur (shihni paragrafin 9 (d) më sipër).

30. Ndërsa mosdeklarimi i pasurive ose burimeve të mëdha të të ardhurave ose përpjekjet e qëllimshme për t’i fshehur ato në përgjithësi mund të konsiderohen të rënda, jo çdo mos respektim i vogël i regjimeve të deklarimit të pasurisë, ose mospërputhje e parëndësishme mes shpenzimeve dhe burimeve të ligjshme, duhet të rezultojë me shkarkim nga detyra (shihni *Sevdari*, cituar më sipër, § 85). Po njësoj, nuk u tregua se vendosja ndaj kërkuesit e një detyrimi të gjerë për të gjurmuar dhe vërtetuar të ardhurat e E.M. – disa prej të cilave të ardhura nga jashtë vendit nga një periudhë e largët – ishte proporcionale në rrethanat e çështjes. KPA-ja nuk paraqiti arsye të mjaftueshme për shkarkimin e kërkuesit për këtë shkak.

31. Përfundimet e tjera të KPA-së (shihni paragrafin 7 më sipër) u konsideruan të pamjaftueshme për të justifikuar, në vetvete, shkarkimin dhe për këtë arsye nuk kërkojnë shqyrtim të veçantë.

32. Gjykata nuk është e bindur që organet e vetingut kanë shqyrtuar me kujdes të gjitha faktet përkatëse, kanë zbatuar standardet përkatëse të të drejtave të njeriut në përputhje me Konventën dhe jurisprudencën e saj, dhe kanë balancuar në mënyrë të përshtatshme interesat në fjalë (shihni *Danileț*, cituar më sipër, § 168). Ndërhyrja nuk arriti ekuilibrin e drejtë të kërkuar mes të drejtave të kërkuesit dhe interesave publikë, duke përfshirë interesin për kthimin e besimit publik në sistemin e drejtësisë (shihni *Sevdari*, cituar më sipër, § 96).

33. Prandaj, në këto rrethana është gjetur shkelje e nenit 8 të Konventës.

ZBATIMI I NENIT 46 DHE 41 TË KONVENTËS

I. KËRKESË PËR ÇAKTIMIN E NJË MASE PERSONALE

34. Gjykata ka gjetur shkelje të nenit 8 sepse shkarkimi i kërkuesit nuk rezultoi proporcional me qëllimet legjitime të ndjekura. Në një kontekst të

ngjashëm, Gjykata ka treguar që rihapja e procesit të vetingut do të ishte e përshtatshme (shihni *Sevdari*, cituar më sipër, §§ 144 45, dhe Rezoluta KM/ResDH(2024)212). KPK-ja ka përfunduar mandatin e tij dhe mandati i KPA-së do të përfundojë gjatë vitit 2026. Neni 179/b § 8 i Kushtetutës rregullon shqyrtimin e proceseve në pritje ose të pazgjidhura pas përfundimit të këtyre mandateve. Nëse kërkuesi e kërkon, do të ishte e përshtatshme rihapja e proceseve dhe rishqyrtimi i çështjes në përputhje me kërkesat e nenit 8, siç tregohet në këtë vendim.

II. DËMI

35. Kërkuesi pretendoi: i. dëmshpërblim për dëmin pasuror që përkon me pagën e tij gjyqësore pas shkarkimit; ii. nëse nuk kthehet në detyrë, paga që ai do të fitonte deri në daljen në pension dhe personi përkatës; iii. rregullimi sipas inflacionit, plus interesi dhe taksat; iv. dëmshpërblim për të ardhurat gjyqësore të ardhshme të humbura; dhe v. dëmshpërblimi për dëmin jopasuror, që duhet të përcaktohet nga Gjykata.

36. Qeveria kundërshtoi pretendimet duke theksuar se kërkuesi kishte të drejtë të ushtronte profesionin e avokatit duke filluar që nga janari 2020 dhe më tej dhe e ka ushtruar.

37. Gjykata i cakton kërkuesit shumën prej 6.000 eurosh për dëmin jopasuror, plus çdo taksë që mund t’i ngarkohet kërkuesit. Duke theksuar gjetjet në paragrafët 34 më sipër, dokumentet në dispozicion dhe praktikën e saj gjyqësore (krahasoni *Sevdari*, cituar më lart, § 149; shihni edhe *Golovin kundër Ukrainës* nr. 47052/18, § 53, 13 korrik 2023), Gjykata i cakton kërkuesit dëmshpërblimin në shumën 20.400 euro për dëmin pasuror, plus çdo taksë që mund t’i ngarkohet atij mbi atë shumë.

III. KOSTOJA DHE SHPENZIME

38. Kërkuesi pretendoi 6.075 euro dhe 5.066 paund britanik në lidhje me tarifat e tij ligjore përpara Gjykatës.

39. Qeveria kundërshtoi pretendimet, me justifikimin që faturat e paraqitura nga kërkuesi nuk e tregonin as mënyrën e pagesës as kryerjen e pagesës.

40. Referuar praktikës së saj gjyqësore (shihni *Sevdari*, cituar më sipër, § 152), Gjykata i cakton kërkuesit një shpërblim prej 6.000 eurosh, plus çdo taksë që mund t’i ngarkohet atij.



PËR KËTO ARSYE, GJYKATA, UNANIMISHT:

1. *Deklaron* të pranueshëm ankimin në lidhje me të drejtën e kërkuarit për respektimin e jetës private;

2. *Vendos* që është shkelur neni 8 i Konventës;

3. *Vendos*:

a) që Shteti i paditur t'i paguajë kërkuarit, brenda tre muajve, shumat e mëposhtme, që do të konvertohen në monedhën e Shtetit të paditur me kursin e këmbimit në fuqi në datën e shlyerjes:

i. 20.400 (njëzet mijë e katërqind euro) EUR për dëmin pasuror, plus çdo taksë që mund t'i ngarkohet kërkuarit mbi atë shumë;

ii. 6.000 euro (gjashtë mijë euro) për dëmin jopasuror, plus çdo taksë që mund të ngarkohet;

iii. 6.000 euro (gjashtë mijë euro) për kostot dhe shpenzimet, plus çdo taksë që mund t'i ngarkohet kërkuarit;

b) nga mbarimi i afatit tre mujor të sipërpërmendur deri në shlyerje, interes i thjeshtë të paguhet për shumat e mësipërme sipas normës të njëjtë me normën marxhinale të kreditimit të Bankës Qendrore Evropiane gjatë periudhës së mospagimit plus tre pikë përqindjeje;

4. *Rrëzon* pjesën tjetër të pretendimit të kërkuarit për kompensim të drejtë.

Bërë në gjuhën angleze dhe njoftuar me shkrim më 5 maj 2026, sipas rregullit 77 §§ 2 dhe 3 të Rregullores së Gjykatës.

Olga Chernishova

ZËVENDËSKANCELAR NË DETYRË

Úna Ní Raifeartaigh

KRYETAR

GJYKATA EVROPIANE E TË DREJTAVE TË NJERIUT
SEKSIONI I TRETË

VENDIM

Kërkesa nr. 55595/17

HASAN ZELA KUNDËR SHQIPËRISË

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (Seksioni i Tretë), e mbledhur më 31 mars 2026, si një Komitet i përbërë nga:

Úna Ní Raifeartaigh, *Kryetare*,
Darian Pavli,

Faqe | 9426

Mateja Đurović, *gjyqtarë*

dhe Olga Chernishova, *zëvendëssekretare e Seksionit*,
Në lidhje me:

kërkesën (nr. 55595/17) kundër Republikës së Shqipërisë të depozituar në Gjykatë në mbështetje të nenit 34 të Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore (Konventa) më 28 korrik 2017 nga një shtetas shqiptar, z. Hasan Zela (kërkuari), i cili ka lindur në vitin 1978, jeton në Tiranë dhe u përfaqësua nga z. R. Zano, një avokat i cili e ushtron profesionin në Tiranë;

vendimin për të njoftuar mbi ankesat – në mbështetje të nenit 6 § 1 të Konventës, në lidhje me të drejtën e kërkuarit për t'iu drejtuar Gjykatës Kushtetuese dhe të drejtën e tij për një vendim të arsyetuar nga Gjykata e Lartë – qeverinë shqiptare (Qeveria), përfaqësuar nga z. O. Moçka, Avokat i Përgjithshëm i Shtetit, dhe për të shpallur pjesën tjetër të kërkesës të papranueshme;

konstatimet e palëve;

Pasi diskutoi, vendos si më poshtë:

LËNDA E ÇËSHTJES

1. Kërkesa ka të bëjë me të drejtën e kërkuarit për t'iu drejtuar Gjykatës Kushtetuese dhe me të drejtën e tij për një vendim të arsyetuar nga Gjykata e Lartë.

2. Më 29 korrik 2001, Gjykata e Rrethit Tiranë (Gjykata e Rrethit) njohu si fakt juridik të drejtat e trashëguara të pronës për kërkuarin dhe trashëgimtarët e tjerë të M. Z. për një sipërfaqe toke prej 830m², me vendndodhje në Tiranë (*vendim vërtetim fakti*).

3. Më 29 mars 2002, Komisioni për Kthimin dhe Kompensimin e Pronës (Komisioni) e rrëzoi kërkesën për njohjen e titullit të pronësisë dhe kthimin e sipërfaqes prej 830 m² të depozituar nga kërkuari dhe trashëgimtarët e tjerë me argumentin se një pjesë e pronës tashmë i ishte kthyer V. J. dhe H. K. Komisioni sugjeroi se kërkesa mund të ridorëzohej sapo të zgjidhej mbivendosja e titujve të pronësisë me anë të procesit gjyqësor.

4. Në vitin 2012, kërkuari dhe trashëgimtarët e tjerë nisën procesin në Gjykatën e Rrethit ku kundërshtuan vendimin e Komisionit në favor të V. J. Më 26 dhjetor 2012, procesi u rrëzua me argumentin se kërkuari dhe trashëgimtarët e tjerë nuk kishin të drejta ligjore.

5. Më 24 tetor 2013, Gjykata e Apelit Tiranë la në fuqi atë vendim.

6. Më 11 korrik 2014, Gjykata e Lartë rrëzoi një ankesë për çështje ligjore të depozituar nga kërkuari



dhe trashëgimtarët e tjerë si të papranueshme, mbështetur në nenin 472 të Kodit të Procedurës Civile (mungesë arsyeshe të vlefshme për apelim).

7. Më 3 mars 2015, kërkuesi dhe trashëgimtarët e tjerë paraqitën një ankesë kushtetuese. Më 30 shtator 2015, Gjykata Kushtetuese, me një formacion me tetë nga nëntë gjyqtarë, rrëzoi ankesën kushtetuese pa paragjykim pasi votimi përfundoi me barazim. Arsyetimi u kufizua në aspektin se nuk ishte mundur të arrihej një shumicë për asnjë prej problematikave të ngritura në çështje. Kërkuesi dhe trashëgimtarët e tjerë u informuan për mundësinë për paraqitjen e një ankesë të re në një datë të mëvonshme, në mbështetje të nenit 74 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese.

8. Më 26 korrik 2016, kërkuesi dhe trashëgimtarët e tjerë paraqitën një ankesë të dytë kushtetuese me argumentin se kishin pritur për gjyqtarin A. Xh., i cili kishte munguar në grupin e parë të procedurave kushtetuese, por që tashmë ishte kthyer në funksionet e tij gjyqësore.

9. Më 7 shkurt 2017, Gjykata Kushtetuese rrëzoi ankesën e dytë me arsyetimin se ishte paraqitur jashtë afatit dyvjeçar të përlogaritur nga data e vendimit të Gjykatës së Lartë më 11 korrik 2014.

10. Në mbështetje të nenit 6 § 1 të Konventës, kërkuesi u ankua se ishte shkelur e drejta e tij për t'iu drejtuar Gjykatës Kushtetuese dhe e drejta e tij për një vendim të arsyetuar nga Gjykata e Lartë.

VLERËSIMI I GJYKATËS

A. Pretendim për shkelje të nenit 6 § 1, në lidhje me të drejtën për t'iu drejtuar Gjykatës Kushtetuese gjatë procesit të vitit 2017

11. Qeveria parashtroi se ankesa e dytë kushtetuese e kërkuesit ishte jashtë afatit. Kërkuesi nuk kishte respektuar afatin dyvjeçar, që kishte filluar që prej datës së vendimit të Gjykatës së Lartë, dhe neni 30 i Ligjit të Gjykatës Kushtetuese nuk parashikonte pezullimin e afatit kohor në çështjet ku një ankesë është rrëzuar sepse nuk është arritur shumica e kërkuar.

12. Kërkuesi argumentoi se afati dyvjeçar do të duhej të ishte menduar të ndërpritej pas dorëzimit të ankesës së parë kushtetuese dhe do të duhej të kishte rinisur vetëm pas rikthimit të gjyqtarit A. Xh.

13. Gjykata thekson se Konventa nuk garanton të drejtën për rihapjen e një çështjeje të mbyllur. Apelimet e jashtëzakonshme me anë të të cilave kërkohet rihapja e një procesi gjyqësor të mbyllur, normalisht nuk përfshijnë përcaktimin e “të drejtave

dhe detyrimeve civile” ose të “asnjë akuze penale”, dhe për këtë arsye, neni 6 vlerësohet i pazbatueshëm për to (shih *Bochan kundër Ukrainës* (nr. 2) [DHM], nr. 22251/08, § 44, GJEDNJ 2015).

14. Në çështjen konkrete, për sa i përket mundësisë së depozitimit të një ankesë të re kushtetuese sapo u plotësua përbërja e Gjykatës Kushtetuese, Gjykata tashmë ka vlerësuar se nuk mund të pranonte se mundësia që rrethanat mund të ndryshonin, dhe se kërkuesi mund të merrte vendimin përfundimtar për ankesën e tij kushtetuese në një moment të papërcaktuar në të ardhmen, mund të përmbushnin kërkesat për sigurinë juridike (shih *Marini kundër Shqipërisë*, nr. 3738/02, § 121, 18 dhjetor 2007, dhe *Prodhim Veshje nr. 2 sh.a. kundër Shqipërisë* [Komiteti], nr. 34649/14, § 10, 17 tetor 2023). Rezulton se vendimi i Gjykatës Kushtetuese, i datës 30 shtator 2015, ishte vendimi përfundimtar në çështjen e kërkuesit.

15. Gjithashtu, Gjykata thekson se në çështjen konkrete, ankesa e dytë kushtetuese u dorëzua jashtë afatit dyvjeçar dhe se ligji nuk parashikonte pezullimin e atij afati kohor. Gjykata arrin në përfundimin se ankesa e dytë kushtetuese ishte një apelim i jashtëzakonshëm, të cilin kërkuesit nuk iu kërkuar që ta dorëzonte, dhe i cili, sidoqoftë, u dorëzua jashtë afatit.

16. Për këtë arsye, kjo pjesë e kërkesës nuk pajtohet *ratione materiae* me parashikimet e Konventës dhe duhet të rrëzohet në përputhje me nenin 35 §§ 3 dhe 4.

B. Shkelje të tjera të pretenduara

17. Kërkuesi u ankua edhe në mbështetje me nenin 6 § 1 të Konventës se ishte shkelur e drejta e tij për t'iu drejtuar Gjykatës Kushtetuese gjatë procesit të vitit 2015, si edhe e drejta e tij për të marrë një vendim të arsyetuar nga Gjykata e Lartë.

18. Qeveria parashtroi se këto ankesa ishin dorëzuar jashtë afatit gjashtëmujor, me argumentin se vendimi i Gjykatës Kushtetuese i vitit 2015 kishte qenë vendimi përfundimtar që kishte shkelur të drejtën e kërkuesit për t'iu drejtuar një gjykate. Në vijim, Qeveria iu referua përfundimeve të Gjykatës në çështjen *Marini* (cituar më sipër, § 146).

19. Kërkuesi argumentoi se vendimi i Gjykatës Kushtetuese, i vitit 2015, nuk përbënte një vendim përfundimtar dhe për këtë arsye, nuk mund të kishte nisur afatin gjashtëmujor për adresimin në Gjykatë.

20. Gjykata thekson se në mbështetje të nenit 35 § 1 të Konventës ajo e shqyrton një ankesë nëse



“janë shteruar të gjitha mjetet e brendshme” dhe nëse ankesa është dorëzuar “brenda periudhës prej gjashtë muajsh nga data në të cilën është marrë vendimi përfundimtar”. Megjithatë, një kërkues nuk është i detyruar që të bëjë rekurs për mjetet që janë të papërshtatshme apo jo efikase (shih *Akdivar dhe të Tjerë kundër Turqisë*, 16 shtator 1996, §§ 65–67, Raportet e Gjytimeve dhe vendimeve 1996-IV; *Vučković dhe të Tjerë kundër Serbisë* (kundërshtimi paraprak) [DHM], nr. 17153/11 dhe 29 të tjerë, §§ 71–73, 25 mars 2014; dhe *Maslák kundër Sllovakisë* (nr.2), nr. 38321/17, § 113, 31 mars 2022). Ndjekja e mjeteve që nuk përmbushin kërkesat e nenit 35 § 1 nuk do të merren në konsideratë nga Gjykata për përcaktimin e datës së “vendimit përfundimtar” ose për përlogaritjen e pikënisjes për rregullin për periudhën gjashtëmujore (shih *Prystavska kundër Ukrainës* (vendim), nr. 21287/02, GJEDNJ 2002-X; *Sapeyan kundër Armenisë*, nr. 35738/03, § 21, 13 janar 2009; dhe *Rizi kundër Shqipërisë* (vendim), nr. 49201/06, § 43, 8 nëntor 2011).

21. Gjykata thekson se në çështjen e kërkuesit, procedurat e kundërshtuara përfunduan më 30 shtator 2015. Përpyekja e pasuksesshme e kërkuesit për të paraqitur një ankesë të dytë kushtetuese më 26 korrik 2016 nuk mund ta sjellë ankesën brenda afatit gjashtëmujor të parashikuar në nenin 35 §1 të Konventës. Rezulton se ankesat e kërkuesit, në lidhje me të drejtën për t’iu drejtuar Gjykatës Kushtetuese në procesin e vitit 2015 dhe e drejta për një vendim të arsyetuar nga Gjykata e Lartë u paraqitën jashtë afatit dhe duhet të rrëzohen në mbështetje të nenit 35 §§1 dhe 4.

PËR KËTO ARSYE, GJYKATA, NË MËNYRË UNANIME,

E shpall kërkesën të papranueshme.

Hartuar në anglisht dhe njoftuar me shkrim më 7 maj 2026.

Olga Chernishova
ZËVENDËSSEKRETARE

Úna Ní Raifeartaigh
KRYETARE

VENDIM **Nr. 25, datë 21.5.2026**

PËR MIRATIMIN E ÇMIMIT TAVAN TË TREGTIMIT ME SHUMICË/PAKICË TË NËNPRODUKTEVE TË NAFTËS DHE TË GAZIT

Bordi i Transparencës dhe Kufizimit të Përkohshëm të Çmimeve të Tregtimit me Shumicë/Pakicë të Nënprodukteve të Naftës dhe të Gazit, në mbështetje të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 186, datë 19.3.2026, “Për shpalljen e situatës së veçantë në tregun e hidrokarbureve”, në zbatim të nenit 21/3 dhe nenit 21/5, të ligjit 8450, datë 24.2.1999, “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre”, të ndryshuar, si dhe të aktit normativ nr. 1, datë 3.4.2026, “Për një shtesë në ligjin nr. 61/2012, ‘Për akcizat në Republikën e Shqipërisë’, të ndryshuar”,

VENDOSI:

1. Të miratojë çmimet tavan/maksimale të tregtimit me shumicë dhe pakicë të nënprodukteve të naftës, për benzinë të standardit SSHEN 2282018 dhe gazoil të standardit SSHEN 5902018.

2. Vlera “Premio” zbatohet sipas publikimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, të një dite më parë.

3. Çmimet e miratuara nga Bordi, të cilat reflektojnë çmimet e nënprodukteve në Bursë, të publikuara nga Agjencia Ndërkombëtare “S&P Global Platts” në USD, në kushtet e livrimit FOB Med, detyrimet doganore/tatimore që aplikohen, si dhe marzhet bruto maksimale të tregtimit (përfshijnë edhe TVSH-në), janë çmime tavan/maksimale në zbatim të metodologjisë së përcaktuar në ligjin nr. 8450, datë 24.2.1999, “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre”, i ndryshuar.

4. Çmimet tavan/maksimale të tregtimit me shumicë dhe pakicë të nënprodukteve, pas zbatimit të metodologjisë të përcaktuar në ligjin nr. 8450, datë 24.2.1999, i ndryshuar, janë si më poshtë:

a) Çmimet tavan (max), për shitjen me shumicë të produkteve:

- 185 lekë/litri për gazoilin;
- 174 lekë/litri për benzinën.

**b) Çmimet tavan (max) për shitjen me pakicë të produkteve:**

- 197 lekë/litri për gazoilin;
- 186 lekë/litri për benzinën.

5. Referuar aktit normativ nr. 1, datë 3.4.2026, “Për një shtesë në ligjin nr. 61/2012, ‘Për akcizat në Republikën e Shqipërisë’, të ndryshuar”, ku është parashikuar, se në rast se çmimi i shitjes me pakicë, për gazoili është më i lartë se 220 lekë/litri, apo për benzinën është më i lartë se 200 lekë/litri, zbatohet niveli 80% i akcizës. Bazuar në zbatimin e metodologjisë sipas pikës 4 të këtij vendimi, çmimet janë nën kufirin e aktit normativ nr. 1, datë 3.4.2026, dhe për rrjedhojë niveli i akcizës do të zbatohet i plotë, 100%.

6. Ngarkohet administrata doganore të bëjë zbatimin në sistem të nivelit të plotë të akcizës për produktin gazoil sipas kodit të NKM-së: 27101944 me 39.376230 lekë/litri, dhe për produktin benzinë sipas kodeve të NKM-së: 27101245 dhe 27101249 me 39.376230 lekë/litri.

7. Asnjë operator ekonomik nuk mund t'i tregtojë këto nënprodukte mbi çmimet tavan të vendimit të Bordit. Çdo operator ekonomik me shumicë dhe pakicë, është i lirë t'i tregtojë këto nënprodukte me çmime më të ulëta se çmimet tavan/maksimale të miratuara nga Bordi.

8. Efektet e këtij vendimi fillojnë në datën 21.5.2026, ora 13:00, deri në një njoftim të dytë të marrë në mbledhjen e radhës. Ky vendim është i detyrueshëm për të gjitha shoqëritë që tregtojnë me shumicë/pakicë produktet dhe nënproduktet e naftës dhe të gazit, në zbatim të ligjit nr. 8450, datë 24.2.1999, “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre”, të ndryshuar.

9. Ky vendim të publikohet në Fletoren Zyrtare, si dhe në faqen zyrtare të ministrisë përgjegjëse për hidrokarburet, ministrisë përgjegjëse për ekonominë, ministrisë përgjegjëse për financat, administratës doganore dhe administratës tatimore.

Kryetare: Delina Ibrahimaj

Anëtarë: Sezar Beqaj, Enea Karakaci, Nimet Veliaj, Arjana Dyrmishi, Dritan Basha, Ilir Binaj, Arlind Fida, Besmir Beja, Klaudio Gega, Ilia Gjermani, Mariglen Bregu

URDHËR

Nr. 125, datë 11.5.2026

**PËR DELEGIMIN E KRYERJES SË
DETYRAVE QË KANË TË BËJNË ME
PROCEDURAT E PROKURIMIT PUBLIK**

Në mbështetje të neneve 28 dhe 29, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurës Administrative të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar; të pikës 5, të nenit 21, të ligjit nr. 162/2020, “Për prokurimin publik”, të ndryshuar; të ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, të ndryshuar; të pikës 2, të nenit 26, dhe germës “i”, të nenit 37, të ligjit nr. 98/2016, “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar; të pikës 2, të nenit 73, të vendimit të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”; të udhëzimit nr. 4, datë 18.6.2021, “Për hartimin e regjistrit të parashikimeve të procedurave të prokurimit publik dhe regjistrit të realizimit të procedurave të prokurimit dhe krijimi i tyre në sistemin e prokurimit elektronik”; si dhe të udhëzimit nr. 7, datë 30.7.2021, “Për mënyrën e zhvillimit të procedurës së prokurimit me mjete elektronike”,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të titullarit të Autoritetit Kontraktor, Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm, kancelarit, z. Shkelzen Mulosmani, për kryerjen e detyrave dhe nënshkrimin e akteve për të gjitha procedurat e prokurimit pranë kësaj gjykate.

2. Organi i deleguar nuk mund ta nëndelegojë këtë kompetencë.

3. Delegimi i kompetencave mbaron me revokimin e aktit të delegimit.

4. Ngarkohet kancelari, z. Shkelzen Mulosmani, për zbatimin e këtij urdhri.

5. Ky urdhër hyn në fuqi më datë 18.5.2026 dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**ZËVENDËSKRYETAR I GJYKATËS SË
SHKALLËS SË PARË TË JURIDIKSIONIT
TË PËRGJITHSHËM KUKËS
Suzana Cena**



Formati 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2026

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 96 lekë



[[FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË[Vulosur elektronikisht nga Qendra e Botimeve Zyrtare]Viti: 2026 - Numri: 105]Datë: 22.05.2026 14:14:08
+02:00]75559fa9-82cb-4ace-82ce-edc7e02a83a9

Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë të një procedure automatike nga një sistem elektronik(Qendra e Botimeve Zyrtare)